**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**
**Zëvendësministri**

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Faqja web: http://www.mete.gov.al

Nr. 3397 Prot. Tiranë, më 26 / 4 / 2011

**Drejtuar:** **Z. Ferdinand Murati**
Drejtor i Pergjithshem Albpetrol ShA
**FIER**

**Z. Leonidha Çobo**
Bankers Petrolium
**FIER**

Z. **Nazmi Kumanova**
Shoqeria " Beralba"
**TIRANE**

Z. **Petrit Duva**
Shoqeria " ACR "
**TIRANE**

Z.**Anila Hajnaj**
Qendra Shqiptare per Zhvillim dhe Integrim" ( Q.SH.ZH.I)
**TIRANE**

Z. **Sami Nezaj**
Organizata "Qendra per Transparence dhe Informim te Lire" (Q.T.I.L.)
**TIRANE**

Z. **Erald Kapri**
Organizata "Youth Media Albania"
**TIRANE**

Qendra Shqiptare per te Drejten Nderkombetare
**TIRANE**

**Lënda:** ***Perfshirje ne Grupin Nderinstitucional te Punes per Nismen per Transparence ne Industrine Nxjerrese (NTIN / EITI).***

Ne mbeshtetje te detyrave per zbatimin e Urdherit te Kryeministrit Nr. 156, date 27.12. 2008 "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional te punës, për ndjekjen e procedurave te kandidimit te Shqipërisë ne nismën për transparence ne industrinë nxjerrëse (NTIN / EITI)" eshte ngritur dhe funksionon grupi perkates i punes qe prej muajit Mars 2009.

Ne takimet e dates 11 - 12.04.2011 me Drejtorin Rajonal te Sekretariatit EITI per Europen & Francophone Afrika z. Tim Bittiger, u trajtuan dhe u rekomanduan masat per zgjerimin e Grupit Nderinstitucional te Punes dhe pjesemarrjen me te gjere te kompanive private dhe nga organizatat e shoqerise civile ne te gjitha mbledhjet e grupit te punes dhe jo vetem ne rangun e perfaqsuesve te tyre, te Z. Perparim Alikaj (FIAA- perfaqsues i grupeve te interesit i zgjedhur prej tyre) dhe Z. Ilir Aliaj (QZHDI-"Qendra e Zhvillimit Demokratik te Institucioneve" perfaqsues i grupeve te shoqerise civile i zgjedhur prej tyre).

Prej vitit 2009 ftesa dhe njoftime te ndryshme jane derguar ne disa kompani te medha private te sektorit te industrise nxjerrese dhe ne organizata te shoqerise civile, te cilet gjithnje e me shpesh kane marre pjese ne takime dhe kane diskutuar per problemet EITI sidomos ne mbledhjet e rendesishme ku eshte realizuar nje vendim-marrje si per planin e veprimit dhe financimin e tij, format e raportimit, miratimin e hartuesit dhe vleresuesit te raportit, etj.

Zgjerimi i aktivitetit te EITI ne vendin tone kerkon qe numri i perfaqsuesve te perhereshem prane Grupit Nderinstitucional te Punes te kompanive private dhe te organizatave te shoqerise civile te rritet dhe keto dy pjese te jene prezente me nje numer te rritur ne te gjitha mbledhjet qe organizohen nga grupi nderinstitucional i punes dhe sekretariati i EITI.
Per kete qellim, ftohen si pjesemarres te perhereshem ne mbledhjet e Grupit Nderinstitucional te Punes ne vijim, nga kompanite ne fushen e industrise nxjerrese qe kane peshe ne te ardhurat e krijuara nga industria nxjerrese dhe organizata te shoqerise civile sipas listes se meposhteme:

Kompanite nga industria nxjerrese( grupet e interesit):

1. Bankers Petrolium
2. Shoqeria " Albpetrol"
3. Shoqeria " Beralba"
4. Shoqeria " ACR "

Organizata te Shoqerive Civile:

1. "Qendra per Zhvillim dhe Demokratizim te Institucioneve" (Q.ZH.D.I)
2. "Qendra Shqiptare per Zhvillim dhe Integrim" ( Q.SH.ZH.I)
3. "Qendra per Transparence dhe Informim te Lire " (Q.T.I.L.)
4. Organizata "Youth Media Albania"
5. Qendra Shqiptare per te Drejten Nderkombetare

Ne kete menyre mbledhjet e grupit do te jene te realizuara me pjesëmarrjen e dymbedhjete anetareve te Grupit Nderinstitucional te Punes, pese perfaqesuesve te Grupeve te Interesit dhe pese perfaqesuesve te Shoqerise Civile.

Si masa te tjera per perfshirje te nje numri me te madh ne takimet e Grupit Nderinstitucional te Punes do te jene ftesat per pjesemarrje edhe per shoqeri, kompani dhe organizata te shoqerise civile te tjera ne keto takime, mbledhje dhe aktivitete qe do te organizohen.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutemi konfirmoni dhe siguroni pjesëmarrjen tuaj duke caktuar perfaqesuesin tuaj ne kete Grup Pune.

**ZËVENDËSMINISTRI**

**NERITAN ALIBALI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
TIRANË